



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:128574

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05760902

A.C.nr.2642/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.S. nga Komuna Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit, lidhur me anulimin e vendimit Nr.02-102/02-0096253/17 të datës 15.10.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1549/20 datë 10.02.2021, në seancën jo publike të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1549/20 datë 10.02.2021, dhe gjykohet si vijon: **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses D.S. me vendbanim në Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të ANULOHET si i paligjshëm Vendimi Nr.02-102/02-0096253/17 datë 05.10.2017, sa i përket refuzimit për pranimin si mësimdhënëse në lëndën e informatikës në Shkollën Fillore të Mesme “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj si dhe ka kërkuar të ANULOHET PJESËRISHT njoftimi për kandidatët e pranuar për mësimdhënëse me numër 535 të datës 30.08.2017 sa i përket shkollës së lartë cekur, përkatësisht sa i përket pranimit të z.D.A., në pozitën e mësimdhënësit të informatikës, si dhe ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit të rishqyrtoj dokumentacionin e kandidatëve sipas konkursit nr.467 të datës 28.07.2017 sa i përket aplikimit për mësimdhënëse në Shkollës Fillore të Mesme “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj, vetëm sa i përket pranimit të kandidatit z.D.A., **E PA BAZUAR.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.1549/20 datë 10.02.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“...I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.S. nga Ferizaj, ushtruar kundër të paditurës Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit, ANULOHET si i paligjshëm Vendimi Nr.02-102/02-0096253/17 të datës 05.10.2017 sa i përket refuzimit për pranimin si mësimdhënëse në lëndën e informatikës në Shkollën Fillore të Mesme “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj si dhe ANULOHET PJESËRISHT Njoftimi për kandidatët e pranuar për mësimdhënëse me numër 535 të datës 30.08.2017 sa i përket shkollës së lartë cekur, përkatësisht sa i përket pranimit të z.D.A., në pozitën e mësimdhënësit të informatikës.

II. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit të rishqyrtoj dokumentacionin e kandidatëve sipas konkursit nr.467 të datës 28.07.2017 sa i përket aplikimit për mësimdhënëse në Shkollën Fillore të Mesme “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj, vetëm sa i përket pranimit të kandidatit z.D.A., në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit, që t’ia paguaj paditëses D.S. nga Ferizaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 135.20 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm...”.

Kundër këtij aktgjykimi pala e paditur në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të prishet aktvendimi i atakuar i Gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet padia për pengim posedimi dhe të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se :

-Ankesa e të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja D.S., me datë 03.08.2022, ka paraqitur padi, kundër të Komuna Ferizaj, Drejtoria e Arsimit, për anulimin e vendimit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 26.10.2017, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqës, dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.1549/20 datë 10.02.2021, me të cilin e ka aprovuar

kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...Meqenëse Vendimi i datës 05.10.2017 është anuluar në tërësi, Gjykata ka anuluar pjesërisht edhe njoftimin për kandidatët e pranuar për mësimdhënës me numër 535 të datës 30.08.2017, vetëm sa i përket përzgjedhjes së z.A., përzgjedhja e së cilit është kontestuar përmes kësaj padie nga ana e paditëses në pozitën e mësimdhënësit të informatikës në Shkollën Fillore të Mesme “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj...”*.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë procedurë kontestimore nuk është kontestuese se nga Komuna Ferizaj është shpallë konkurs për mësimdhënës në Shkollën e Mesme “Kuvendi i Arberit” në Ferizaj, për tre mësimdhënës për informatikë.

Po ashtu nuk është kontestuese se në bazë të konkursit të shpallur janë pranuar tre mësimdhënës, dhe atë E.K., kandidati D.A., dhe kandidatin Y.I., ndërsa paditësja nuk ka pasur sukses.

Po ashtu nuk është kontestuese se asnjëri nga kandidatët nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet që janë kërkuar në bazë të konkursit të shpallur nga Komuna Ferizaj.

Gjykata e Apelit ka vendosur ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar bazuar në shkresat e lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 35.5 të Ligjit për arsimin parauniversitar në të cilin nen në ndër të tjera thuhet se *“Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve ... për mësimdhënës, merren për bazë kushtet, si janë: arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim të përcaktuar në këtë ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm...”*.

Në këtë kontekst konstatohet se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar i është referuar të drejtës materiale kur ka vendosur të aprovoi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, sepse bazuar në nenin 35.5 të Ligjit nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, është lënë në diskrecion të komisionit për përzgjedhjen e kandidatit të përkohshëm për mësimdhënës, nëse të gjithë kandidatët

të cilët kanë aplikuar nuk i plotësojnë kushtet për kualifikim bazuar në konkursin e shpallur për mësimdhënës.

Gjykata e shkallës së parë është nevojite vetëm të konstatojë nëse paditësja i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara në Konkursin e shpallur nga e paditura për mësimdhënës në Shkollën e Mesme “Kuvendi i Arberit”, në Ferizaj, për tre mësimdhënës për informatikë, ndërsa të tre kandidatët e pranuar si mësimdhënës për informatikë në Shkollën e Mesme “Kuvendi i Arberit” në Ferizaj nuk i kanë plotësuar të gjitha kushtet, meqë vetë paditësja ka konstatuar se edhe ajo vetë nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara në Konkursin e shpallur nga e paditura për mësimdhënës në Shkollën e Mesme “Kuvendi i Arberit” në Ferizaj, Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar e ka konstatuar të drejtën materiale, këtë vlerësim Gjykata e Apelit e bazon duke i kualifikuar faktet kësaj procedure kontestimore në raport me përkufizimin ligjor që përmban dispozita e neni 35.5 të Ligjit nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Në rastin konkret komisioni i themeluar nga e paditura i ka zgjidhur kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet më të përafërta, duke u bazuar edhe në nenin 35.4 të Ligjit nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“Mësimdhënësit do të zgjedhën nga një komision i themeluar nga DKA...”*.

Sa i përket vendimi mbi shpenzimet e procedurës Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të këtij aktgjykimi dhe i njëjti është marrë bazuar në nenin 450 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: *“Secila palë paraprkisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 208 dhe 209 pika (c), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2642/2021 datë 20.05.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Bujar Muzaqi